

Izmit DURMISHI

SI E FLASIM DHE SI E SHKRUAJMË SHQIPEN SOT?!

Abstrakti: Të shkruash e të flasësh me kujdes gjuhën amtare do të thotë të japësh ndihmesë në thesarin kulturor mbarëkombëtar. Kjo është ndër detyrat tona më fisnike dhe të domosdoshme që duhet ushtruar pa ndalur. Zotërimi i shqipes së normëzuar është proces që kërkon mund dhe angazhim të pandërprerë, pasi gjuha është materie e gjallë që ndryshon, zhvillohet e pasurohet. Në këtë pikëpamje, duhet pasur kujdes sidomos në përdorimin e trajtave normative të shqipes nëpër të gjitha rrafshet gjuhësore. Punimi që po shtjellojmë, në radhë të parë, synon të nxjerrë në pah gjuhën e folur dhe të shkruar në përditshmërinë tonë, gjegjësisht shmangiet më të shpeshta që po i bëhen standardit të shqipes nëpër rrafshet gjuhësore në formën e folur dhe të shkruar.

Shkolla, mediat e shkruara dhe ato elektronike si dhe institucionet tjera publike, kanë ndikim të madh në masë, prandaj përfaqësuesit e tyre domosdoshmërisht duhet të bëjnë përpjekje që ta zotërojnë shqipen letrare - standarde në një shkallë të lartë. Përpos lëshimeve në formën e folur, mjaft të mëdha janë edhe shmangiet që po i bëhen standardit edhe në të shkruar. Po t'u hedhim sy faqeve të gazetave e revistave të ndryshme, do të takojmë gabime gramatikore e drejtshkrimore nga më të ndryshmet. Në këtë pikëpamje, kërkesat për një përmirësim të dukshëm të standardit, për një gjuhë të pasur e të pastër të gazetave e revistave, kanë qenë dhe do të mbeten ndër temat më me interes, jo vetëm për studiuesit e gjuhës, por edhe për lexuesit e zakonshëm.

Fjalë kyçe: rrafshet gjuhësore, shmangie, standardi, gazetë, revistë.

Kumtesa që po shtjellojmë ka për qëllim të ofrojë fakte mbi gjendjen e shqipes sot, gjegjësisht mbi formën e folur dhe të shkruar të saj. Që në fillim të punimit duhet shtuar se, forma e folur dhe ajo e shkruar e shqipes së normëzuar, duhet trajtuar në mënyrë paralele, pasi që të dy format (ajo e folur dhe e shkruar) nënkuptojnë standardin e shqipes. Kujdesi për standardin e folur dhe të shkruar duhet të jetë i njëjtë, pavarësisht se ajo që bie në sy më së shpeshti është forma e shkruar e tij. Do të ishte gabim nëse çështjen e standardit do ta kufizonim vetëm në fushën e drejtshkrimit. Norma letrare e gjuhës së folur shqipe dhe asaj të shkruar, ka të bëjë me të gjitha nënsistemet, qoftë ai fonetik, leksikor, gramatikor, stilistikor apo drejtshqiptimor e drejtshkrimor. Më poshtë do të nënvizojmë disa dukuri nga më të shpeshtat nëpër rrafshet e ndryshme gjuhësore, që shtrembërojnë shqipen e normëzuar letrare.

a) rrafshi fonetik

Përdorimi i zanores *e* të theksuar

Siç dihet, shqipja letrare ka vetëm zanore gojore, prandaj zanoret hundore nga pikëpamja e normës drejtshqiptimore, si dukuri dialektore duhet mënjanuar. Nga këtu, fjalët me zanoren *e* të theksuar të ndjekura nga një bashkëtingëllore hundore (*m*, *n*, *nj*) në pajtim me

atë që kërkon norma drejtshqiptimore dhe drejtshkrimore e shqipes duhet të shqiptohen me *e* (dhe jo me *ë*), si p.sh., *emër, dhemb, dhembje, femër, gjemb, shemb, tremb, thembër, zemër* etj., (dhe jo: *ëmër dhëmbje, fëmër, gjëmb, shëmb, trëmb, thëmbër, zëmër^{xi}* etj.), siç i dëgjojmë të shqiptuara e të shkruara gabimisht në përditshmëri. Këtë dukuri të gabuar në shqiptim, për fat të keq e dëgjojmë nga shumë folës, mësues dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, bile edhe në televizionin shqiptar.

Përdorimi i zanores *ë* të theksuar

Nuk duhet ngatërruar as përdorimi i *ë*-së së theksuar i shqipes letrare me *a*-në hundore të gegërishtes. Shqiptimi letrar kërkon të thuhet me *ë* dhe jo me *â* fjalët: *běj, dëm, dëmtoj, dhëmb, dhëndër, ëmbël, i ëmbël, ëndërroj, ënjta, këngë, lëng, mbrëmë, mëngë, nxënës, thënie, zëri* etj., të cilat shpesh i dëgjojmë të shqiptuara me format e gabuara dialektore geqe: *bâj, dâm, dhâm, dhândërr, âmël > âmbël, ândërr, ânjta, kânga, lâng, mrâmë < mbrâmë, mângë, nxânës, thânie* etj. Thyerje të normës drejtshqiptimore e drejtshkrimore paraqet edhe përdorimi i trajtave: *la, nja, njajës, i njajtë, njani, njana, (unë) za* etj., në vend të formave të folura e të shkruara të shqipes standarde: *lë, një, njëjës, i njëjtë, njëri, njëra, (unë) zë* etj. Norma drejtshkrimore e shqipes kërkon të shkruhen me *e* edhe fjalët e tipit: *i gjerë, gjerësi, gjerësisht, zgjeroj, zgjerim, krehër* etj., të cilat në gjuhën e folur, të shumtën e rasteve i takojmë me *ë*: *i gjërë, zgjëroj, krëhër* etj.

Përdorimi i zanores *ë* të patheksuar

Ndër çështjet më problemore të drejtshqiptimit të shqipes është paaftësia për të përdorur drejt zanoren *ë* të patheksuar. Vështirimet fonetike flasin se *ë-ja* e patheksuar është tingull i shkurtër, i reduktuar, i ngritjes së mesme. Zanorja *ë* e patheksuar mund të gjendet para rrokjes së theksuar, si p.sh. *anëtár, dëbòrë, ftohtësi*, ose pas rrokjes së theksuar, në trup a në fund të fjalës, si p.sh. *végël, dásme, púnë*. Problem më vete paraqet përdorimi i zanores *ë* paratheksore te fjalët e prejardhura me prapashtesë pasi shqiptohet mjaft e rrudhur. Në stilin e plotë të shqiptimit ajo ndihet më e qartë, kurse në stilin jo të plotë më e dobët. Kështu zanorja *ë* e patheksuar shqiptohet e rrëguar në fjalët: *gjatësi, gjerësi, gjuhëtar, hollësi* etj., por në të shkruar dhe në shqiptim, sipas normës së drejtshqiptimit dhe drejtshkrimit letrar shkruhen pa *ë* fjalët: *amtar, besnik, fillestar, furrta, kishtar, lojtar, pishtar, rojtar* etj. Kësisoj, në mjaft raste e gjejmë të shkruar gabimisht fjalën *antar^{xi}* në vend të: *anëtar* (me *ë* paratheksore).

Në ca ese studentësh dhe shkrime gazetash kemi gjetur këto trajta të shkruara gabimisht: *kurësesi, gjithëkund, gjithëçka*; në vend të: *kurrësi, gjithkund, gjithçka*. Te përemrat e pacaktuar dhe ndajfoljet që kanë si pjesë të parë fjalët *gjithë* ose *kurrë*, *ë-ja* nuk shkruhet dhe nuk shqiptohet.

Shmangie nga standardi vërejmë edhe gjatë përdorimit të gabueshëm të zanores *y* në vend të zanores *u* dhe anasjelltas. Në shkrimet e shpeshta të studentëve dhe ato gazetareske kemi vërejtur format: *bylmet, byfe, fryte^{xi}* etj., në vend të: *bufe, bulmet, fruta*. Në të kundërtën,

fjalët: *burazer, musafir, musliman, mushteri, virtit* etj., i gjejmë të shqiptuara dhe të shkruara gabimisht, në vend të gjejëseve të normëzuara të shqipes: *byrazer, mysafir, mysliman, myshteri, virtyt* etj. Thyerje të trajtave të shqiptimit normativ të shqipes në këto lloje shkrimesh përbën edhe përdorimi i gabuar i disa fjalëve ku ngatërrohen zanorja *i* me *y*-në. Kështu kemi hasur të shqiptuara dhe shkruara gabimisht, fjalët: *hupa, krymb, krypë, qylim, rryp*; në vend të fjalëve: *hipa, krimb, krip, qilim, rrip*. Ngatërresa, qoftë në shqiptim apo shkrim vërejmë edhe gjatë përdorimit të togjeve të *ie* dhe *je*. Në ligjërimin bisedor dhe atë libror shpesh dëgjojmë të thuhet, madje edhe të shkruhet *dieg, ndieftë* (tr.e dëshirores), *ndieva* (tr. e së kryerës së thjeshtë); në vend të trajtave normative: *djeg, ndjefsha, ndjeftë, ndjeva*.

Disa shembuj të nxjerrë nga shkrimet e ndryshme (ese studentësh, shkrime gazetareske) na dëshmojnë se, shmangie nga standardi përbën edhe përdorimi i gabuar i bashkëtingëllores *ç* në vend të bashkëtingëllores *sh*. Kështu, qoftë në të folur apo në të shkruar, kemi hasur të përdorura format e gabuara *çfaqje, çfaros, çfletoj*,^{xi} në vend të trajtave normative: *shfaqje, shfaros, shfletoj*. Po kështu edhe: *çvendos, çvesh* në vend të trajtave të normëzuara *zhvendos, zhvesh*. Në mënyrë të gabuar shkruhet edhe bashkëtingëllorja *j* në tipin e fjalëve: Maqedonija, Shqipërija, Hungarija, Bullgarija etj., që mund të vërehen shpesh në disa televizione në Maqedoninë e Veriut edhe sot e kësaj dite. Përdorimin e *j-së* te emrat e përveçëm të shteteve, siç dihet, dëmton rëndë normën drejtshkrimore të shqipes standarde. Bashkëtingëllorja *j* në këto raste është bukurtingëlluese që dëgjohej, por nuk shkruhet. Shkrimin e pavend të kësaj bashkëtingëlloreje e kemi vërejtur edhe në shkrime të ndryshme të studentëve e nëpër gazeta, te foljet e parregullta të tipit: *flej, ngrej, lëj, zëj, dij, pij, rrij*. Shqipja e normëzuar, për foljet e përmendura ka trajtat: *fle, ngre, lë, zë, di, pi, rri*.

Në kundërshtim me normën shqiptimore dhe drejtshkrimore është edhe shtimi i bashkëtingëllores *h* në fillim të disa fjalëve si: *hec, harrij, hik*. Të njëjtat duhet t'i shqiptojmë dhe shkruajmë: *ec, arrij, ik*. Disa shembuj të tjerë fjalësh na mundësojnë të kuptojmë se, fare lehtë mund të përdoren gabimisht (në vend të njëri-tjetrit) edhe tingujt *r* dhe *rr* që paraqesin dy fonema të ndryshme. Këtë ngatërresë më së miri e vërejmë te shembujt *arra* dhe *ara*, *morri* (emër) dhe *mori* (folje), *ruaj* dhe *rruaj* (mjekrën), *birrë* (pije) dhe *birë* (vrinë).

b) rrafshi morfologjik

Edhe në rrafshin morfologjik kemi ilustruar disa shmangie që po i bëhen standardit, sidomos në mediat e shkruara dhe elektronike që kanë ndikim të madh në masë. Këtyre gabimeve nuk mund t'u shmanget as TVSH si medium i rëndësishëm kombëtar. Ngjashëm edhe televizionet private e shtetërore këtu në Maqedoninë e Veriut, vazhdojnë pa ndalur që ditët e javës t'i shënojnë me shkronja të mëdha, si p.sh. *E Hënë, E Enjte, E Diel*^{xi} etj. Siç dihet, norma e shqipes standarde kërkon që në fillim fjalie të shkruhet me të madhe vetëm nyja, kurse pjesa e fjalës shkruhet me të vogël: *E hënë, E enjte, E diel*, kurse midis rreshtit, të njëjtat shkruhen me shkronja të vogla (*e hënë, e enjte, e diel*). Thyerje të rënda që po i bëhen shqipes standarde

llogariten edhe ato që kanë të bëjnë me shkrimin e emrave të gjinisë femërore. Një televizion shtetëror, emisionin javor për shëndetësi e shkruan me formën “Bised me mjekun”, në vend të: “*Bisedë me mjekun*” që paraqet një shkelje të rëndë të normës drejtshkrimore të shqipes standarde. Në një televizion tjetër në Maqedoninë e Veriut, në mënyrë të ngjashme, pa zanoren –ë fundore të trajtës së pashquar i kemi vërejtur të shkruara edhe oikonimet (emrat e qyteteve) me format *Strumic* e *Kriva Palank*, në vend të: *Strumicë* e *Kriva Pallankë*. Dihet se emrat e gjinisë femërore në trajtën e pashquar dalin me mbaresën –ë, ndërkaq në të shquarën, mbaresën –a, –ja.. Po kështu fjalën *muzikë* e gjejmë të shkruar me trajtën *muzik* (pa ë fundore) në një televizion të këtushëm, që përbën një shkelje të rëndë normës drejtshkrimore të shqipes.

Shmangie nga norma e shqipes standarde paraqet edhe shkrimi i gabueshëm i foljes së përbërë sipas formës *pregadis-pregaditem*^{xi}. Kjo trajtë po përdoret me të madhe nëpër shkrime të ndryshme, gazeta dhe televizion. Ata që e flasin shqipen duhet të dinë se parafjala *pre-* është parafjalë tipike greke, ndërkaq shqipja ka parafjalën e brumit të saj mjaft të përdorur *për-*. Prandaj, duhet të përdorim formën e drejtë normative të shqipes me parafjalën *për+gati(s)* = *përgatis* - *përgatitem* (bëj gati ushqimin, d.v., bëhem gati për mësim, d.p.).

Shkruhen gabimisht nëpër shkrime të ndryshme, gazeta e televizion edhe numërorët themelorë tre (tri) sipas gjinisë. Në televizion kemi dëgjuar të thuhet, madje edhe të shkruhet fjalja : *Tre ditë zie...* në vend të: *tri ditë zie...* Numërori *tre (tri)* ndryshon sipas gjinisë së emrit. Shkruhet forma *tre* kur numërori shoqërohet me emra të gjinisë mashkullore, si p.sh.: *tre djem*, *tre gazetarë*, *tre shqiptarë*, ndërkaq, shkruhet forma *tri* kur numërori shoqërohet me emra të gjinisë femërore: *tri vajza*, *tri gazetare*, *tri shqiptare* etj. Në masmedia të shkruara dhe elektronike, si dhe në shkrime të tjera të përditshmërisë (ese e hartime), ndeshim gabimisht të shkruar edhe formën e fjalës (foljes) *shëndroj* në vend të *shndërroj*. Nga ky varg i shmangieve të panumërta që po i bëhen standardit të shqipes, nuk kursehet as edhe fjala *kulturë*, të cilën e hasim të shkruar, bile edhe në medime, me formën “*kultur*” (pa ë fundore).

Thyerjet, shtrembërimet, sajaset interesante e të pakuptueshme që nuk ngjasojnë aspak me shqipen e natyrën e saj, po vazhdojnë të përdoren edhe në rrafshin morfo-sintaksor. Në vazhdim po japim ca shembuj që kemi vërejtur në hartimet e nxënësve, esetë e studentëve, si dhe në shkrimet e ndryshme gazetareske. Në shembullin: mësimi ka filluar *para një muaj dite* !, vërejmë se shprehja “*një muaj dite*” është e huaj (sipas modelit sllav “*mesec dana*”), të cilës shqipja i përgjigjet me shprehjen “*para një muaji*”. Pra, forma e drejtë e fjalisë është: *mësimi ka filluar para një muaji*!. Natyrën e shqipes e ngarkon tepër edhe përdorimi i gabueshëm i emrave, që ka çuar në harresë plotësisht një tipar të rëndësishëm – kategorinë gramatikore të *shquarsisë* dhe *pashquarsisë* së emrave të përveçëm që shqipja e ka ruajtur gjatë gjithë historisë së zhvillimit të saj. Sajesa të tilla të gabuara lexojmë edhe si tituj gazetash, si p.sh. “*Majko takoi Bler*”, të cilën shqipja e thotë “*Majkoja takoi Blerin*” (Njësoj siç thuhet: *Agimi takoi Blerimin*). Siç dihet, sajaset e tilla vijnë si rezultat i ndikimit të gjuhëve të huaja, e në veçanti si rezultat i emërtimit të fëmijëve tanë me emra të huaj. Një dukuri e shëmtuar për vet shqipen është edhe pagëzimi i fëmijëve

shqiptarë me emra të huaj, të ashtuquajtur “emra të modës” si Andi, Roni, Albert, Robert, Blendi, Roland, Romeo etj., një pjesë e të cilëve po përdoren edhe në shtresat qytetare e intelektuale. Një sajësë tjetër sintaksore që na ka rënë në sy nëpër shkrime, dhe e cila nuk përkon aspak me natyrën e shqipes standarde është sajësja “me fillim në orën 20”. Kjo formë është kalk sipas modelit sllav “so početok vo 20 časot”. Forma e drejtë e kësaj sintagme në shqipë është “në ora 20”. Një dukuri tjetër që vërejmë si zakonisht në lajmet e televizionit është përdorimi i gabueshëm i shprehjeve: Këtu kemi përfunduar lajmet, nga ndikimi i italishtes; në shqip thuhet: *dhamë lajmet, përfunduam ditarin, këtu po përfundojmë*.

Duke përcjellë për një kohë të gjatë gjuhën e mediave elektronike, kam vërejtur se gabimisht po përdoret edhe përemri pyetës *kush* në numrin shumës (kur pyetet për sende), në vend të përemrit në shumës *cilët*, si p.sh.: Kush janë faktorët kryesorë për zhvillimin e turizmit? (për: *Cilët* janë faktorët kryesorë për zhvillimin e turizmit?). Një dukuri tjetër që vërejmë edhe sot e kësaj dite në ligjërimin e folur në emisione të ndryshme televizive në Kosovë është prirja e gjuhës dialektore që përdorin ata. Kemi përshtypjen se, shmangiet nga standardi ata i bëjnë për arsye të mosnjohjes sa duhet të gjuhës letrare ose dëshirës për t’u rikthyer në gegërishte. Marrë në tërësi, në mediat tona, qoftë në ligjërimin e folur apo të shkruar, kemi prirjen e depërtimit të elementit të huaj në shqipen. Ky ndikim vjen nga sllavishtja (maqedonishtja e serbishtja), italishtja, gjermanishtja e anglishtja. Kjo trysni ka përfshirë së tepërmi rrafshin morfologjik dhe atë sintaksor. Shpesh vërejmë ndërtime sipas gjedheve të huaja, qoftë në të folur apo në të shkruar. Në disa raste kam parë të shkruar lutjen me këtë formë, *Deri te*: Fakulteti i Mjekësisë, sipas modelit të gjuhëve sllave (*do Medicinski Fakultet*). Shqipja e shkruar togfjalëshin me formën e dhanores: Fakultetit të Mjekësisë. Të njëjtën formë kemi mundësi ta dëgjojmë edhe në ligjërimin e folur, kur gazetarët ndonjëherë, në fund të emisioneve debative na drejtohen me fjalitë: “Porosia juaj *deri te* ata që na ndjekin (shikuesit)”. Shqipja e thotë këtë me: porosia juaj *për* shikuesit (ata që na ndjekin). Sajesat e tilla morfosintaksore janë të dëmshme për natyrën e shqipes dhe i bien ndesh normës letrare.

c) rrafshi leksikor

Edhe në fushën e leksikut të shqipes vërejmë trysninë e madhe që po ushtrojnë gjuhët e vendeve të zhvilluara me të cilat shqipja është në kontakt. Çështja e ndikimit të një gjuhe në tjetrën, ka kohë që po shqyrtohet në qarqe të ndryshme shkencore e intelektuale të gjuhësisë. Janë shkruar libra, studime e artikuj për këtë temë këtu e më gjerë, por me siguri ka edhe mjaft çka të thuhet. Siç ndodh edhe me gjuhët e tjera, shqipes i lejohet të huazojë fjalë nga gjuhët e tjera për të cilat ka nevojë, pasi gjuhët janë materie e gjallë që japim dhe marrim fjalë nga njëra-tjetra. Huazimet mund të shërbejnë edhe si mjet pasurimi për gjuhën, nëse do t’i përshtateshin sistemit të gjuhës amtare gjatë shkrirjes së tyre. Ajo që na brengos së tepërmi është dukuria e vërshimit të fjalëve dhe strukturave të huaja në shqipen, pa nevojë. Jemi dëshmitarë se shqipja standarde përditë e më shumë po bie pre e ndikimeve të huaja dhe të panevojshme, në një kohë të zhvillimeve të mëdha tekniko-teknologjike e shkencore. Kemi përshtypjen se pjesa më e

madhe e shqiptarëve sot, pavarësisht vendit ku jetojnë dhe profesionit që ushtrojnë, qofshin ata tregtarë, politikanë, gazetarë, mësues etj., përpos faktorëve të ndryshëm shoqërorë, politikë dhe ekonomikë që ndikojnë në prishjen e gjuhës së tyre, përballen edhe me moskujdesin e duhur për ruajtjen shqipes - këtij elementi bazë të identitetit kombëtarë, siç e quanin shumica e rilindasve.

Vëmendjen për ruajtjen e gjuhës na e tërhoqën qysh herët edhe rilindasit tanë, si De Rada, Kristoforidhi, Konica e të tjerë, të cilët na e lanë një porosi të qartë – ruajtjen e gjuhës amtare nga ndikimet e huaja. Porosia e rilindasve tanë, po edhe përpjekjet e gjuhëtarëve të sotëm e intelektualëve tjerë për ruajtjen e shqipes nga ndikimet e huaja, është sa madhore, aq edhe fisnike. Ndikimet e huaja e të panevojshme për shqipen standarde vijnë më së tepërmi nga italishtja, gjermanishtja, anglishtja e sllavishtja.

Shqipja standarde s'ka nevojë që në vend të fjalëve të brumit të saj, të përdorë fjalë të huaja që ia zënë frymën gjuhës dhe e ngulfatin atë skajshmërisht, si b.f. abrogoj (shfuqizoj, heq ligjin), arrest (ndalim), apel (thirrje), abuzim (shpërdorim), brifing (konferencë shtypi), donator (dhurues), elektorat (zgjedhës), esencë (thelb), disonancë (keqtingëllim), eskalim (shkallëzim), fermer (bujk), injorim (shpërfillje), internacional (ndërkombëtar), kampanjë (fushatë), kauza (çështja), frustrim (mashttrim), flesh lajme (lajme të shkurtra), komunitet (bashkësi), konfrontoj (ngatërroj), konstituent (përbërës), bord (këshill), live muzikë (muzikë e gjallë), avantazh (përparësi, epërsi), koincidencë (rastësi), konfidencë (mirëbesim), primar (parësor), rrisk (rrezik), seleksionoj (përzgjedh), sensibilizim (ndërgjegjësim), spiker (folës, drejtues), sposto (zhvendos), suportoj (duro, mbështet), uploj (ngarkoj), downloj (shkarkoj), intermediar (ndërmjetës), involvoj (përfshij) etj.

Për fund të shtojmë se, standardi i shqipes nuk është çështje që mësohet brenda ditës. Ai fillon të mësohet në shkollat fillore, vazhdon në ciklin e mesëm të shkollimit e deri në atë universitar. Përsosja e gjuhës letrare kombëtare vazhdon në mënyrë të pandërprerë. Përgjegjësitë për kultivimin e standardit të shqipes, në radhë të parë, duhet kërkuar tek institucionet më me ndikim, siç janë televizioni, radioja e mjetet tjera elektronike për gjuhën e folur, si dhe shkolla, gazetatat e revistat, bashkë me librat, për formën e shkruar të shqipes. Prandaj, le të kultivojmë para së gjithash ndjenjën për dashurinë dhe ruajtjen e gjuhës sonë të bukur – këtij elementi të rëndësishëm të identitetit tonë kombëtar, pavarësisht profesioneve që ushtrojmë në shoqëri. Le të përpiqemi për zotërimin e standardit të shqipes, sepse shqipja e standardizuar është thesari ynë i çmuar dhe i vetëm, që mban gjallë qenien tonë kombëtare.

Bibliografia:

Memushaj, Rami, *Shqipja standarde - Si ta flasim dhe ta shkruajmë*, Tiranë, 2002.

Poloska, Agim, *Kultura e të shprehurit*, Menora, Shkup, 2007.

Shkurtaj, Gjovalin, *Si të shkruajmë shqip*, Toena, Tiranë, 2008.

Rrokaj, Shezai, *Çështje të gjuhës shqipe 2*, Tiranë, 2009.

Rrokaj, Shezai, *Çështje të gjuhës shqipe 3*, Tiranë, 2014.

Hamiti, Asllan, *Kultura e gjuhës për të gjithë*, Shkup, 2018.